



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 193 Prot.

Tiranë, më datë 13.06.2024

VENDIM  
Nr. 168, datë 13.06.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.06.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit të potencialit arkeologjik për projektin “Rindërtimi i hotelit ekzistues 4 kat+ 1 kat nëntokë”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” Durrës, me aplikues JF Architectural Designer dhe zhvillues **Z. Nedi Ismaili**;
  2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Rindërtimi i hotelit ekzistues 4 kat+ 1 kat nëntokë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
  3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI

